



14 Shtator 2016

## MEMO

Me datën 10 Shtator 2016, përfaqësues (deputetë) të Komisionit Parlamentar për Veprimtaritë Prodhuese dhe Mjedisin, Ministrisë së Mjedisit, Bashkive të reja, Fakultetit të Shkencave Pyjore, Shoqatës për Autonomi Vendore, Fondacionit “Bashkojmë Vlerat e Natyrës me Njerezit”, Federatës Kombëtare të Pyjeve u mbledhën në takim në pestë të Komitetit Koordinues Kombëtar. Ky Komitet është ngritur me qëllim lehtësimin e një dialogu kombëtar mes aktorëve të ndryshëm të përfshirë në qeverisjen e pyjeve dhe kullotave në Shqipëri, si dhe krijimin e një mjedisi të përshtatshëm politik, ligjor dhe institucional për ruajtjen dhe zhvillimin e pyjeve, si dhe për të siguruar të drejta mbi pyllin për përdoruesit tradicionalë.

Takimi u organizua në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Angazhimit, lehtësuar nga Koalicioni Ndërkombëtar i Tokës dhe vënë në zbatim nga Federata Kombëtare e Pyjeve.

Pjesëmarrësit vlerësuan kontributin e Komitetit, diskutuan me përgjegjësi për sfidat aktuale me të cilat përballet sektori pyjor, vlerësuan veçanërisht preokupimin dhe kontributin e deputetëve pjesëmarrës në Komitet për problemin e pyjeve, si dhe dhanë sugjerimet e tyre për përmirësimin e qeverisjes së pyjeve nga Bashkitë dhe komunitetet vendore si më poshtë:

### **Për Parlamentin:**

- Organizmin e dëgjësive më të shpeshta publike me të gjithë aktorët e përfshirë në sektorin e pyjeve lidhur me projekt ligjin e ri për pyjet.

### **Për Ministrinë:**

- Njohjen dhe diskutimin e projekt -ligjit për pyjet me aktorët e interesuar.
- Transparencë dhe llogaridhënie për procesin e inventarizimit dhe regjistrimit të pyjeve.
- Lehtësimin e procesit të dorëzimit të gjithë dokumentacionit pyjor nga njësitë e mëparshme vendore tek Bashkitë (hartat përkatëse, të dhënat statistikore për fondin pyjor e kullor, projektet, planet e inventarizimit dhe planet e mbarështrimit, të dhënat e kadastrës me sipërfaqet e pyjeve dhe kullotave sipas destinacionit, si dhe ndryshimet e ndodhura gjatë kohëve).
- Lejimin e decentralizimit të mëtejshëm të kompetencave që lidhen me miratimin e Planeve të Mbarështrimit, miratimin e punimeve për përmirësimin e pyjeve dhe produktet e dyta pyjore.
- Organizmin e takimeve informuese me stafet teknike të Bashkive lidhur me zbatimin e ligjit dhe vendimeve që lidhen sidomos me sigurimin e druve të zjarrit për komunitetet vendore.
- Ministria e Mjedisit duhet të kërkojë sipas ligjit në fuqi delegimin e buxhetit për mbi 600 punonjës që duhet të përfshihen në strukturat e sapo krijuara të Bashkive.

### **Për organizmat ndërkombëtar/donatorë/partnerë (Banka Botërore, Ambasada Suedeze, Delegacioni European, Fondacioni CNVP)**

- Mbështetjen më të fortë të reformave institucionale dhe ligjore.
- Përsheptimin e procesit të vlerësimit të aplikimeve pranë Projektit të Shërbimeve Mjedisore për 136 Shoqata Përdoruesish dhe individë.

- Rishikimin e mekanizmit të monitorimit të projekteve fituese tek PSHM. Monitorimi duhet të bëhet nga strukturat e Bashkisë sipas ligjit numër 48/2016, neni 11, pika h (kontrollin dhe marrjen në dorëzim të punimeve të kryera në pyje e kullota, pavarësisht nga burimi i financimit).
- Forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve të Shoqatave, Federatave rajonale dhe Federatës Kombëtare të Pyjeve dhe Kullotave Komunale, si dhe pjesëmarrjes së grave në proceset vendim-marrëse.

### **Për Bashkitë:**

- Krijimin e drejtorive të shërbimit pyjor (DSHP) në bashki me specialistë të aftë me arsim profesional pyjor.
- Planifikimin afat shkurtër për punimet dhe shërbimet në Bashki, si dhe hartimin e strategjisë dhe planeve të përgjithshme për zhvillimin perspektiv të pyjeve dhe kullotave të bashkisë.
- Caktimin e sipërfaqeve të pyjeve të fshatit për t'i dhënë në përdorim të përbashkët të fshatit dhe në përdorim të familjeve rurale sipas traditave dhe nevojave të familjeve rurale.
- Regjistrimin e pyjeve dhe kullotave të bashkisë në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si dhe regjistrimin e pyjeve dhe kullotave të dhëna në përdorim të fshatit dhe familjeve rurale (shpenzimet për regjistrimin fillestar të përballohen nga shteti).
- Mbështetjen dhe nxitjen e bashkëpunimit me Shoqatat dhe Federatat e Përdoruesve të Pyjeve e Kullotave.
- Paisjen me mjete dhe infrastrukturë të stafeve profesionale të ngritura pranë bashkive. Kjo kosto mund të parashikohet në buxhetet e Bashkive për vitin 2017.
- Ngritjen e fidanishteve pyjore për plotësimin e nevojave me fidanë të prodhuar në vend, pasi janë plotësisht mundësitë, si dhe nxitja e aktiviteteve turistike.

### **Për Fakultetin e Shkencave Pyjore:**

- Nxitjen dhe thellimin e kërkimit shkencor për pyjet e komunitetit.
- Fakulteti të japë kontribut konkret gjatë diskutimit dhe hartimit të projekt-ligjit për pyjet.

### **Për Federatën Kombëtare dhe Shoqatat e Pyjeve:**

- Federatat dhe Shoqatat e Pyjeve të vazhdojnë të ngrenë zërin për më shumë të drejta për komunitetet që jetojnë pranë pyjeve.
- Të bëhen pjesë e vazhdueshme e komenteve për projekt-ligjin e pyjeve.
- Të vazhdojnë punën për forcimin e kapaciteteve të komuniteteve vendore dhe shoqatave, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit të tyre për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve.
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Bashkitë dhe strukturat e tyre.

### **Për Shoqatën për Autonomi Vendore:**

- Shkëmbimin e eksperiencave dhe përhapjen e modeleve të mira.
- Së bashku me Federatën Kombëtare dhe ato rajonale, të organizojnë takime të përbashkëta dhe trajnime kualifikuese për stafet e bashkive.